Kronikë

Bulqizë, kultivuan në një miniserë 150 fidanë kanabis që do i mbillnin në pyll, 3 të arrestuar! Sekuestrohen edhe 2 armë gjahu

3 persona janë vënë në pranga të policisë së Bulqizës për kultivim kanabisi

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
25 Korrik, 13:26 | **Përditesimi: 25 Korrik, 13:47**

BULQIZË- Një operacioni anti-kanabis i zhvilluar në Bulqizë ka çuar në pranga 3 persona. Sipas policisë në kuadër të operacionit antikanabis i koduar 'Gracka', u arrestuan shtetasit Agron Cami, 52 vjeç, Arlent Cami, 30 vjeç dhe Ermal Lika, 34 vjeç

Këta të tre persona sipas policisë kishin kultivuar bimë narkotike në një miniserë në fshatin Golevisht, dhe më pas do t'i transportonin në pyll, me kafshë pune, me qëllim mbjelljen e tyre në tokë.

LEXO EDHE:
Asgjësohen 8330 rrënjë kanabis në qarkun e Shkodrës, Lezhës e Kukësit

Nga hetimi proaktiv rezultoi se këta shtetas kishin kultivuar në një miniserë, rreth 150 bimë narkotike, të cilat më pas kanë tentuar t'i transportojnë më kafshë pune, në pyll, me qëllim mbjelljen e tyre në tokë.

Gjithashtu, shërbimet e Policisë kanë ushtruar kontroll në banesën e Agron Cami, ku janë gjetur dhe sekuestruar 2 armë gjahu që ai i mbante pa leje.

Vijon puna për identifikimin dhe kapjen e shtetasve të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: ermal lika | arlent cami | agron cami | kanabis | Dibër | bulqizë

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Tjetër luftë për vulën në PD, a duhen anuluar zgjedhjet për kryetarin e ri?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

EMRI/Sherr në Bulqizë! Plagosi me thikë 37-vjeçarin, arrestohet autori
25 Korrik, 10:16



Librazhd/ Dronët zbulojnë 491 bimë kanabisi të kultivuara në një zonë të shpyllëzuar në fshatit Rinas, kultivuesit nuk dihen ende
24 Korrik, 12:19



Po eksploronte një zonë malore dhe u rrëzua me motoçikletë, policia shpëton turistin austriak në Selishtë të Dibrës
24 Korrik, 10:44

Dronët zbulojnë 609 bimë kanabisi të kultivuara në malësinë e Krujës, s'dihen autorët
24 Korrik, 09:47

Asgjësohen 290 bimë narkotike në Lezhë, arrestohet 45-vjeçari! Në hetim kryeplaku i fshatit Delbnisht si dhe inspektori i zonës
23 Korrik, 13:24

Ishte asfaltuar para 10 ditësh, mjetet e rëndа të gurores shkatërrojnë rrugën në Bllacë të Bulqizës! Banorët në protestë: Mos transportoni materiale mbi tonazh
22 Korrik, 18:26

Ishin mbjellë nëpër fshatra, asgjësohen 1691 bimë kanabis në qarkun e Lezhës
22 Korrik, 15:07

Rrihet brutalisht shefi i Policisë bashkiake të Bulqizës, në kërkim 3 autorët! Një prej tyre i dënuar për vrasje në 2013 (EMRAT)
21 Korrik, 11:57

U kap me 500 doza kanabisi në makinë, arrestohet 28-vjeçari në Vlorë
20 Korrik, 14:27

Dronët zbulojnë mbi 2 mijë bimë kanabisi të kultivuara në disa fshatra në Vaun e Dejës! Autorët nuk dihen ende
20 Korrik, 14:09

Aksion antikanabis në Tropojë, zbulohen 686 bimë të kultivuara në zona të pyllëzuara! Nën hetim kryetari i fshatit dhe dy përgjegjës të shërbimit pyjor
20 Korrik, 10:19

EMRI/ Iu zbuluan 150 bimët e kanabisit të kultivuara në Çinar të Krujës, arrestohet 32-vjeçari! Në kërkim vëllai i tij
20 Korrik, 09:56

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje